

## Vendim nr. 14 datë 20.01.2025

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahim, Marjana Semini, Fiona Papajorgji, anëtarë, në datën 20.01.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 30 (SH) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

**KËRKUESE:** **SHOQËRIA “SIMA COM” sh.p.k.**, përfaqësuar nga avokat Kastriot Selita, me prokurë.

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i vendimeve nr. 303, datë 24.10.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 175 (87-2023-290), datë 22.12.2023 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2024-490, datë 19.03.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 4, 11, 17, 41, pika 5, 42, pika 2, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika, shkronja “i” dhe 141 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27, 71, 71/a dhe 71/b të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese (*Mbledhja e Gjyqtarëve*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fiona Papajorgji, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

### V Ë R E N:

#### I

#### Rrethanat e çështjes

1. Kërkesja, shoqëria “SIMA COM” sh.p.k., është subjekt tregtar me objekt veprimtarie në

fushën e ndërtimit. Në kuadër të ushtrimit të aktivitetit tregtar, në vitin 2019 ajo është pajisur me leje ndërtimi dhe në vijim ka ndërtuar dy objekte në Ishull Shëngjin, Lezhë, me sipërfaqe ndërtimore të përgjithshme 1728.3 m<sup>2</sup>, të shtrira në 4 parcela toke arë (një nga të cilat me sipërfaqe 1148 m<sup>2</sup>, identifikuar si pasuria nr. 2/50), të regjistruara në pronësi të personave të tjerë. Pas përfundimit të objekteve dhe lidhjes së kontratave të shkëmbimit me pronarët e regjistruar të tokës, njëra ndërtesë me sipërfaqe 1166 m<sup>2</sup> dhe trualli nën të me sipërfaqe 2559 m<sup>2</sup> (ku përfshihej edhe parcela me sipërfaqe 1148 m<sup>2</sup>) është regjistruar si pasuri (identifikuar me nr. 2/551) në pronësi të kërkueses, duke u pajisur ajo me certifikatë pronësie në datën 18.05.2021.

2. Ndërkohë, më herët, Prokuroria për Krime të Rënda ka regjistruar procedimin penal nr. 339 të vitit 2016, i cili, si pasojë e ndryshimeve institucionale për shkak të reformës në drejtësi, iu transferua Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*), pas krijimit të saj në vitin 2019. Mbi këtë bazë, kjo e fundit ka regjistruar procedimin penal nr. 29, datë 20.12.2019 (*procedimi penal nr. 29/2019*) për veprat penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, “Trafikimi i narkotikëve”, “Grupi i strukturuar kriminal” dhe “Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”, të parashikuara nga nenet 283, 283/a, 333/a dhe 334 të Kodit Penal (KP), ndaj disa personave konkretë të dyshuar si autorë të tyre. Nga provat e mbledhura gjatë hetimit kanë rezultuar fakte në lidhje me veprime të kundërligjshme të disa personave për tjetërsimin e pronave dhe përfitimin e tyre në kundërshtim me ligjin, duke filluar me identifikimin e parcelave të tokës me pronësi të shtetit, gjetjen e personave të interesuar për t’u pajisur me tokë, falsifikimin e dokumenteve të pronësisë dhe deri në regjistrimin e saj e pajisjen e tyre me certifikata pronësie. Në këtë veprimtari kriminale personat përfitues të pronave kanë përfshirë edhe persona të tjerë, të afërt apo të njohur të tyre, duke u kaluar në mënyrë fiktive pasuritë dhe më pas, me qëllim final, për t’i kaluar në pronësinë e vetë. Një nga pasuritë e paluajtshme në pronësi të shtetit - e përfituar përmes veprimeve të kundërligjshme sipas organit të akuzës - është edhe pasuria tokë arë me sipërfaqe 1148 m<sup>2</sup>, e cila, fillimisht, në shkurt të vitit 2015 është regjistruar në pronësi të shtetasit V.G dhe, më pas, në korrik të këtij viti, në pronësi të shtetasit Gj.N., sipas një kontrate shitblerjeje.

3. Në datën 26.07.2022 Prokuroria e Posaçme ka depozituar në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Shkallës së Parë*) kërkesën për caktimin e masës së sigurimit pasuror sekuestro preventive, ndër të tjera, edhe për pasurinë tokë arë me sipërfaqe 1148 m<sup>2</sup>. Kërkesa është pranuar nga gjykata me vendimin nr. 345, datë 28.07.2022, me arsyetimin se ekziston dyshimi i bazuar në prova për kryerjen e veprës penale, se pasuria për të cilën kërkohet vendosja e masës është produkt i veprës penale dhe për të lejohet konfiskimi sipas nenit 36 të KP-së, dhe se ekziston rreziku se disponimi i lirë i kësaj pasurie mund të bëhet shkak për zgjatjen

e pasojave të veprës penale ose për lehtësimin e kryerjes së veprave penale të tjera, duke marrë parasysh rrethanat dhe veçoritë e faktit penal të dyshuar. Ndaj këtij vendimi nuk është paraqitur ankim nga ndonjë i interesuar.

4. Në vijim, në përgjigje të kërkesës së kërkueses, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Lezhë, me shkresën e datës 19.12.2022, ka pajisur kërkuesen me kartelën e pasurisë së regjistruar në pronësi të saj, e cila përmbante edhe shënimin: “Vendoset sekuestro preventive nga Prokuroria pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar mbi bazën e vendimit nr. 354, datë 28.07.2022 të kësaj gjykate.”.

5. Më tej, në datën 18.07.2023 kërkuesja ka paraqitur kërkesë në gjykatë për heqjen e sekuestros ndaj pasurisë së saj të vendosur në kuadër të procedimit penal nr. 29/2019, duke e mbështetur kërkesën në nenin 274, paragrafi 3, të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*). Për këtë kërkesë, GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 303, datë 24.10.2023, ka vendosur rrëzimin e saj me arsyetimin se, ndryshe nga sa pretendonte kërkuesja, nuk kanë ndryshuar kushtet e zbatimit të masës së sekuestros preventive të vendosur me vendimin e saj të datës 28.07.2022, ndaj të cilit kërkuesja nuk ka bërë ankim edhe pse ka marrë dijeni për të në dhjetor të vitit 2022. Sipas asaj gjykate, nevojat e sigurimit që pasuria objekt gjykimi të mbetet e sekuestruar vijojnë të ekzistojnë ende. Po sipas saj, procedimi penal në kuadër të të cilit është vendosur masa e sekuestros preventive rezulton të jetë paraqitur për gjykim në themel, i cili ndodhet në fazën procedurale të paraqitjes së diskutimeve përfundimtare.

6. Mbi apelin e kërkueses, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Apelit*), me vendimin nr. 175 (87-2023-290), datë 22.12.2023, ka miratuar vendimin nr. 303, datë 24.10.2023 të GJKKO-së së Shkallës së Parë, me të njëjtin arsyetim se në kuptim të nenit 274, pika 3, të KPP-së nuk ka ndryshuar asnjë nga kushtet që kanë çuar në caktimin e masës së sigurimit pasuror “Sekuestro preventive” për pasurinë objekt ankimi. Sipas gjykatës së apelit, rrethanat e pretenduara nga kërkuesja nuk përbëjnë rrethana të zbuluara apo të vërtetuara pas caktimit të masës së sigurimit pasuror të sekuestros preventive, pasi ato kanë ekzistuar si të tilla që në momentin e caktimit të saj dhe janë vlerësuar nga gjykata në atë rast. Pavarësisht kësaj, në përgjigje të pretendimeve të kërkueses, ajo gjykatë ka arsyetuar se për caktimin e sekuestros preventive nuk kërkohet “dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova” që personi, ndaj pasurisë së të cilit vendoset sekuestroja preventive, të jetë i dyshuar, por mjafton dyshimi për ekzistencën e një vepre penale dhe se masa në fjalë bie mbi sendin, duke qenë ajo një veprimtari e përkohshme ruajtëse që synon të realizojë, nëpërmjet garantimit të vlerave procedurale-penale si një interes publik, mbrojtjen shoqërore. Në caktimin e kësaj mase po ashtu, vijon ajo, është e parëndësishme përkatësia e pronësisë

së sendit, pra nëse sendi i përket të hetuarit/dyshuarit apo një të treti. Fakti që në momentin e caktimit të masës pasuria ka qenë e regjistruar në pronësi të kërkueses, sipas gjykatës së apelit, nuk përbën shkak të ligjshëm për përjashtimin e saj nga sekuestroja preventive dhe, për rrjedhojë, as për heqjen e kësaj mase sipas përcaktimeve të nenit 274, pika 3, të KPP-së. Masa e sekuestros preventive, vijon ajo, nuk mund të hiqet automatikisht, për shkak se kalimi i pronësisë së sendeve është i lidhur me veprat penale që po hetohen/gjykohe, për rrjedhojë edhe ligjshmëria e krijimit apo fitimit të kësaj pasurie nga kërkuesja do të jetë objekt i hetimit/gjyqimit, ndërkohë që, në interpretim edhe të nenit 275 të KPP-së, është gjykata ajo që me vendimin përfundimtar për zgjidhjen e çështjes në themel do të disponojë edhe për kthimin e sendit të sekuestruar atij që i takon, kur nuk duhet të urdhërojë konfiskimin e tij. Së fundi, sipas gjykatës së apelit, KPP-ja nuk njeh konceptin e revokimit të masës së sigurimit pasuror të sekuestros preventive, por atë të heqjes së saj, çka do të thotë se gjykata mund të disponojë heqjen e masës vetëm kur kanë ndryshuar kushtet e zbatimit të saj, pra kur kemi lehtësim ose mosekzistencë të tyre, çka në rastin konkret nuk rezulton. Kundër vendimit të gjykatës së apelit ka ushtruar rekurs kërkuesja.

7. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-490, datë 19.03.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se ai nuk përmban asnjë nga shkaqet që parashikon neni 432 i KPP-së. Sipas Gjykatës së Lartë, ndërhyrja në gëzimin e qetë të pronësisë është proporcionale në kuadër të një procedimi penal, në kushtet kur kanë ekzistuar kriteret e nenit 274 të KPP-së, ndërsa pretendimet e kërkueses janë marrë në shqyrtim nga gjykata e apelit, e cila ka argumentuar gjerësisht vendimmarrjen e saj, sikurse edhe gjykata e shkallës së parë në rrezimin e kërkesës.

8. Në datën 10.10.2024 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, i cili, pasi është plotësuar sipas parashikimeve të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 24.10.2024. Me vendimin e datës 17.12.2024 Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve.

## II

### Pretendimet e kërkueses

9. **Kërkuesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimet gjyqësore objekt kundërshtimi i kanë cenuar:

9.1. *Të drejtën për proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

9.1.1. *Së drejtës së aksesit*, pasi asnjë gjykatë nuk i ka dhënë përgjigje kërkesës së saj nëse mund të caktohej një masë sigurimi pasuror ndaj një subjekti për të cilin nuk është

ngritur asnjë akuzë penale, nuk ka dyshime për ligjshmërinë e fitimit të së drejtës së pronësisë dhe kjo e drejtë nuk është shfuqizuar apo deklaruar e pavlefshme me asnjë mjet juridik dhe nga asnjë organ kompetent shtetëror.

9.1.2. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme*, pasi Gjykata e Lartë dhe GJKKO-ja e Apelit kanë mbajtur qëndrime që kanë tejkaluar qëndrimin e akuzës, duke u shprehur edhe për çështje për të cilat nuk janë vënë asnjëherë në lëvizje nga asnjë subjekt procedural dhe mbi bazë të asnjë ligji që është në fuqi.

9.1.3. *Së drejtës për t'u dëgjuar*, pasi prokuroria dhe gjykatat kanë refuzuar të shqyrtojnë dhe të konsiderojnë si subjekt procedural personin juridik, pasurinë e të cilit vendosën ta kufizojnë me një masë të sigurimit pasuror. Kushtetuta dhe legjislacioni shqiptar nuk lejojnë kufizimin e së drejtës së pronësisë së një qytetari të lirë që nuk është subjekt i ndonjë mase procedurale kufizimi.

9.1.4. *Parimit të sigurisë juridike*, pasi ajo është mbajtëse e titullit të ligjshëm të pronësisë dhe sipas legjislacionit në fuqi gëzon të gjitha të drejtat që i jep ky titull, i cili nuk është goditur asnjëherë gjyqësish apo nuk është vënë në diskutim nga asnjë institucion i zbatimit të ligjit. Në rastin konkret, vullneti i ligjvënësit, i shprehur në pikës 2 të nenit 36 të KP-së, ka dështuar.

9.1.5. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë përgjigje faktit se në kushtet kur çështja ishte dërguar për gjykim dhe prokuroria kishte vlerësuar se nuk kishte asnjë element paligjshmërie në të drejtën e pronësisë së kërkueses, pasuria e saj nuk mund të sekuestrohej sipas përcaktimeve të KPP-së. Ajo gjykatë nuk ka arsytuar se përse i ka konsideruar të pabazuara shkaqet e ngritura në rekurs.

9.2. *Të drejtën e pronës*, të garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, pasi ndonëse pasuria është fituar në mënyrë të ligjshme, për shkak të vendosjes së masës së kufizimit ajo u konsiderua e paligjshme, ndërsa ky paragjykim-dyshim nuk u bazua në asnjë provë sipas KPP-së.

### III

#### Vlerësimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve

##### A. Për legjitimitimin e kërkueses

10. Çështja e legjitimitimit është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe neni 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private

dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

11. Në lidhje me legjitimitimin *ratione personae*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, individi është subjekt i cili mund të paraqesë ankim kushtetues individual vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejta, duke provuar se është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të. Kjo do të thotë se kërkuesi duhet të provojë legjitimitimin e tij si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial (*shih vendimet nr. 65, datë 30.11.2023; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se kërkuesja legjitimohet në aspektin procedural, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në ankimin kushtetues dhe, po kështu, edhe në aspektin substancial, pasi një pjesë e pasurisë së sekuestruar rezultoi e regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme në emër të saj.

12. Në lidhje me *kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata ka pohuar se në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, mbrojtja kushtetuese ka një funksion subsidiar, që do të thotë se ajo mund të kërkohet vetëm për një vendim përfundimtar, të çfarëdolloj forme, që përmyll procesin gjyqësor, pasi individi ka shteruar mjetet dhe rrugët e tjera ligjore. Cenimi i të drejtave themelore, përfshirë atë për një proces të rregullt ligjor, mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apelimeve (*shih vendimet nr. 29, datë 16.04.2024; nr. 18, datë 19.03.2024 të Gjykatës Kushtetuese*). Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se objekt kundërshtimi janë vendimet gjyqësore të të tria shkallëve të gjyqimit, me të cilat është rrëzuar kërkesa e kërkueses për kthimin e pronës së sekuestruar, duke mbetur kështu praktikisht në fuqi masa e sekuestros preventive për pasurinë e paluajtshme të saj. Nisur nga fakti se Gjykata i ka përfshirë në juridiksionin e saj këto vendime, të cilat ndonëse me karakter të përkohshëm dhe që nuk vendosin për themelin e çështjes, ndërhyjnë në të drejtat kushtetuese individuale (*shih vendimet nr. 29, datë 16.04.2024; nr. 18, datë 19.03.2024 të Gjykatës Kushtetuese*), Mbledhja e Gjyqtarëve, me shumicë

votash<sup>1</sup>, çmon se kërkuesja e ka përmbushur edhe këtë kriter legjitimimi për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

13. Në lidhje me legjitimimin *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se vendimi i Gjykatës së Lartë mban datën 19.03.2024, ndërsa ankimi kushtetues individual është dërguar përmes shërbimit postar në datën 10.10.2024. Sipas informacionit të përcjellë nga Gjykata e Lartë rezulton se vendimi është publikuar në faqen zyrtare të asaj gjykate në datën 12.06.2024. Duke iu referuar kësaj date, si momenti i konstatimit të cenimit të drejtave, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se ankimi kushtetues individual është paraqitur brenda afatit 4-mujor, rrjedhimisht kërkuesja legjitimohet edhe *ratione temporis*.

15. Për sa i takon legjitimimit *ratione materiae*, kërkuesja ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në disa drejtime (akses, gjykata e paanshme, për t’u dëgjuar, siguria juridike dhe standardi i arsytimit), si dhe së drejtës së pronës, të garantuara nga nenet 41 dhe 42 të Kushtetutës. Kërkuesja i ka mbështetur pretendimet në argumentin kryesor se asaj i është kufizuar e drejta e pronësisë për një pasuri të paluajtshme të poseduar në mënyrë të ligjshme, ndërkohë që nuk ka qenë palë dhe as nuk është dëgjuar në procesin penal, i cili ka vendosur sekuestrimin e pronës së saj.

16. Lidhur me vendimet e sekuestrimit të pasurive të paluajtshme, Gjykata i ka trajtuar ato kryesisht në këndvështrim të nenit 41 të Kushtetutës, duke theksuar se në të tilla raste ajo mund të ndalet rast pas rasti edhe në aspekte të veçanta të së drejtës për proces të rregullt ligjor, për sa ato mund të ndikojnë drejtpërdrejt në të drejtën substanciale në vetvete. Ndaj, ajo i ka trajtuar aspektet e tjera procedurale të lidhura me të drejtën e pronës sipas garancive kushtetuese (*shih vendimin nr. 18, datë 19.03.2024 të Gjykatës Kushtetuese*). Nën këtë optikë, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson që t’i shqyrtojë pretendimet e kërkueses në aspektin e së drejtës së pronës, të garantuar nga neni 41 i Kushtetutës dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

---

<sup>1</sup> Gjyqtarët Ilir Toska dhe Marjana Semini votuan për mosplotësimin e këtij kriteri legjitimimi, me arsyetimin se vendimet objekt kundërshtimi janë jopërfundimtare, në kuptim të nenit 131, shkronja “f”, të Kushtetutës, ndaj nuk mund t’i nënshtrohen gjykimit kushtetues, qëndrim ky i mbajtur dhe i elaboruar në mendimet paralele të vendimit nr. 18, datë 13.03.2024 të Gjykatës, si dhe në vendime të tjera të kësaj natyre në vijim.

17. Në lidhje me këtë kriter të legjitimitit, qëndrimet e gjyqtarëve u ndanë në drejtim të përmbushjes së kërkesës që pretendimet e ngritura në ankimin kushtetues të mos jenë haptazi të pabazuara, si një nga kriteret që verifikohet për kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, në kuptim të nenit 31/a të ligjit nr. 8577/2000 dhe nenit 23 të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës (*Rregullorja e Gjykatës*).

18. Sipas njërit qëndrim<sup>2</sup>, kërkesja i është drejtuar Gjykatës duke u ankuar ndaj vendimeve të gjykatave të zakonshme që kanë refuzuar heqjen e sekuestros ndaj pasurisë së saj të paluajtshme me sipërfaqe 1148 m<sup>2</sup>. Ndërkohë, sikurse u evidentua më sipër (*shih paragrafin 3 të vendimit*), kërkesja nuk ka paraqitur ankim ndaj caktimit të masës së sekuestrimit të pasurisë, që do të thotë se, në thelb, nuk ka ushtruar mjetet efektive në dispozicion për të kundërshtuar kushtetutshmërinë e asaj mase. Për këto arsye, kushtetutshmëria e sekuestros preventive nuk mund të vihet në dyshim përmes ankimit të paraqitur, pra nuk mund të ngrihen pretendime në drejtim të kufizimit të pronës, ndërhyrje e cila rezulton të jetë bërë me ligj (është vendosur me vendim gjyqësor sipas rasteve të parashikuara nga ligji procedural penal); ka pasur qëllim legjitim (mbarëvajtjen e procedimit penal); është proporcional (në drejtim të nevojës, përshtatshmërisë dhe ashpërsisë). Nga ana tjetër, thelbit të pretendimit të kërkuësës, pra ndryshimit të kushteve të masës së sekuestros, gjykatat e zakonshme i kanë dhënë përgjigje.

19. Kështu, gjykata e shkallës së parë ka argumentuar se pasuria e paluajtshme është produkt i veprës penale (*send që lejohet të konfiskohet sipas nenit 36 të KP-së*) dhe disponimi i lirë ka rrezik të sjellë zgjatjen e pasojave të veprës penale ose lehtësimin e kryerjes së veprave penale të tjera (*duke marrë parasysh rrethanat dhe veçoritë e faktit penal të dyshuar se është kryer*). Po sipas gjykatës së shkallës së parë, procedimi penal gjendet në fazën e gjykimit në themel, ndaj ekziston ende nevoja e sigurimit që pasuria objekt gjykimi të mbetet e sekuestruar (*shih faqet 23 - 24 të vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë*). Ky argument është vlerësuar i drejtë nga gjykata e apelit, e cila, gjithashtu, ka arsyetuar se në mungesë të një elementi të ri apo të ndryshëm për sa u takon tre aspekteve për të cilat vendoset masa e sigurimit të sekuestros preventive, si: (i) dyshimi i arsyeshëm për kryerjen e një veprë penale; (ii) lidhja ndërmjet sendit dhe veprës penale apo qenia e tij produkt i veprës penale; (iii) ekzistenca e rrezikut se nga disponimi i lirë mund të rëndohet apo zgjaten pasojat e veprës penale ose mund të lehtësohet kryerja e veprave të tjera penale, nuk ka shkak për heqjen e sekuestros preventive në kuptim të pikës 3 të nenit 274 të KPP-së (*shih faqet 23 -24 të vendimit të GJKKO-së së Apelit*). Gjithashtu, gjykata e apelit i ka dhënë përgjigje edhe pretendimeve të kërkuësës lidhur me

---

<sup>2</sup> Gjyqtarët Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji dhe Sandër Beci votuan për moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.



ndryshimet e pësuar të pasurisë për shkak të bashkimit të saj me tre pasuri të tjera, duke vlerësuar se këto rrethana kanë qenë të njohura nga gjykata që ka caktuar masën e sigurimit pasuror (*shih faqen 26 të vendimit të GJKKO-së së Apelit*).

20. Po kështu, gjetjet e gjykatave të faktit janë vlerësuar të bazuara edhe nga Gjykata e Lartë, e cila ka çmuar se me të drejtë është arritur në konkluzionin se në rastin konkret rezultojnë e provuar se nuk ka ndryshuar asnjë nga kushtet që kanë çuar gjykatën në caktimin e masës së sigurimit pasuror “Sekuestro preventive”, pasi pasuria e paluajtshme dyshohet se përbën produkt të veprave penale dhe si të tilla ato janë ende objekt hetimi/gjykimi (*shih paragrafin 28 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Në analizë të vendimmarrjes së gjykatave të zakonshme, sipas këtij qëndrimi, arsyetimi ka bazë ligjore të qartë dhe përmban një analizë të individualizuar për pronën e sekuestruar dhe kushtet e sekuestrimit, ndaj përfundimi i arritur për të mos pranuar heqjen e sekuestrimit nuk rezultojnë i paarsyeshëm; si dhe nuk përmban të meta të tilla serioze që të vënë në dyshim faktin se vazhdimi i masës është i domosdoshëm në kuadër të mbarëvajtjes së procedimit penal të themelit. Ndaj, nën dritën e kësaj analize, ankimi kushtetues individual i kërkueses nuk plotëson kriterin e legjitimitetit *ratione materiae*.

21. Sipas qëndrimit tjetër<sup>3</sup>, pretendimet e kërkueses për cenimin e nenit 41 të Kushtetutës nuk duken të jenë haptazi të pabazuara, pasi gjykatat e zakonshme, ndonëse kanë identifikuar pasurinë që dyshohet të jetë produkt i veprës penale, që është pasuria nr. 2/50, me sipërfaqe 1148 m<sup>2</sup>, e kanë shtrirë kufizimin mbi të gjithë pasurinë e përfutur nga kërkuessa pas bashkimit të pasurive të paluajtshme nr. 2/31, nr. 2/30 dhe nr. 2/90 dhe pas kalimit të pjesëve takuese të pronarët e truallit (sipas kontratës së sipërmarrjes), konkretisht mbi pasurinë nr. 2/551, me sipërfaqe truall 2559 m<sup>2</sup> dhe ndërtesë 1166 m<sup>2</sup>, për të cilën kërkuessa aktualisht nuk mund të pajiset me kopje të rifreskuar të kartelës dhe hartës treguese. Edhe pse gjykatat e zakonshme kanë pranuar se tre pasuritë e tjera me të cilat është bashkuar pasuria nr. 2/50 janë përfituar në mënyrë të ligjshme, ato nuk rezultojnë që të kenë analizuar kufizimin në ushtrimin e tagrave të pronësisë mbi të gjithë pronën e rezultuar nga ky bashkim, të regjistruar në emër të kërkueses, në raport me përcaktimet e nenit 17 të Kushtetutës, veçanërisht në drejtim të proporcionalitetit të kësaj ndërhyrjeje. Edhe pse në vlerësimin tonë masa e sekuestrimit është vendosur në kuadër të një procedimi penal, sipas përcaktimeve të dispozitave materiale dhe procedurale penale (neni 36 i KP-së dhe neni 274 i KPP-së), pra prezumohet se ndërhyrja është bërë me ligj dhe për një interes publik, kritere që gjenden të trajtuara edhe në vendimmarrjen e gjykatave të zakonshme, atyre i mungon arsyetimi në drejtim të kriterit të përshtatshmërisë së masës në rastin konkret, duke pasur

---

<sup>3</sup> Gjyqtarët Holta Zaçaj, Sonila Bejtja dhe Genti Ibrahim i votuan për kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

parasysh se vetë ato gjykata nuk e kanë vënë në dyshim karakterin e ligjshëm të pasurive të tjera të paluajtshme, të bashkuara për qëllime të investimit, të cilat nuk rezultojnë të dyshohen se kanë burim veprimtari të paligjshme penale apo se janë të lidhura në ndonjë formë me të tilla. Po ashtu, gjykatat nuk kanë arsyetuar as në lidhje me pasojat me natyrë ekonomike që rrjedhin në këtë rast nga investimi për kërkuesen apo persona të tretë.

22. Referuar praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*), masat me natyrë preventive të caktuara gjatë procedurave penale synojnë që pasuritë, origjina dhe burimi i të cilave dyshohet se ka natyrë jo të ligjshme, të hiqen nga qarkullimi civil, me qëllim që të bëhet e mundur rivendosja e situatës që do të ekzistonte nëse ato pasuri nuk do të ishin fituar në këtë formë ose mënyrë, duke qenë këto masa të pavarura nga dënimi apo shkalla e fajësisë së personit të përfshirë (*shih Ulemek kundër Serbisë, datë 2 shkurt 2021, § 53*). Qëllimi parësor është shmangia e pasurimit të paarsyeshëm që rrjedh nga veprat penale, duke i privuar personat në fjalë nga fitimet e paligjshme, ndaj të tilla masa janë konsideruar se kanë një qëllim riparues se sa ndëshkues (*po aty, § 57*). Në të kundërt, konsiderohen masa ndëshkuese ato që drejtohen në mënyrë më të zgjeruar ndaj të ardhurave të veprimtarive të paligjshme, duke përfshirë produktet e tyre, pa u kufizuar në pasurimin ose fitimin aktual (*shih Welch kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 9 janar 1995, § 33*). Në këtë kuptim, duke pasur parasysh natyrën “riparuese” të këtyre lloj masash, të cilat nuk synojnë ndëshkimin penal të autorit të veprës penal, por kanë si qëllim parësor ndalimin e futjes në qarkullimin civil dhe tjetërsimin e pasurive të dyshuara se janë fituar në mënyrë të paligjshme, duke i paraprirë edhe një konfiskim të mundshëm të pasurisë në përfundim të procesit penal, merrte rëndësi analiza e përshtatshmërisë së masës së kërkuar nga prokurori për kufizimin e së drejtës së pronësisë, çka qartazi mungon në vendimet e kundërshtuara.

23. Thënë sa më sipër, në kontekstin e rrethanave të çështjes konkrete në shqyrtim, për sa kohë që masa e sekuestros e kundërshtuar nga kërkuesja ka një karakter të përgjithshëm, ndërkohë që një pjesë e pasurisë së sekuestruar nuk duket të ketë lidhje me veprat penale apo të jetë rezultat i tyre, çka do të thotë se pretendimet e kërkueses nuk duket të jenë haptazi të pabazuara ose spekulative në thelb, si dhe duke pasur parasysh edhe qëndrimet e GJEDNJ-së në lidhje me natyrën dhe qëllimin e këtyre masave paraprake, vlerësojmë se kishte vend për kalimin e kësaj çështjeje për shqyrtim në seancë plenare. Kjo do t'i jepte mundësinë Gjykatës që të elaboronte praktikën e saj sipas qëndrimeve të GJEDNJ-së, duke shqyrtuar në themel pretendimet e kërkueses në këndvështrim të rrethanave të çështjes konkrete, si në drejtim të kufizimit të tagrave të pronësisë, ashtu edhe shtrirjes së këtij kufizimi, në kushtet që duket se ky kufizim ka dalë tej kufijve të procedimit penal dhe tej pasurisë që dyshohet si produkt i veprës penale, duke u shtrirë edhe mbi pasurinë për të cilën nuk ekziston një

dyschim i arsyeshëm se përbën produkt të veprimtarisë kriminale. Në drejtim të proporcionalitetit të ndërhyrjes dhe përshtatshmërisë së masës, i takonte Gjykatës që të vlerësonte çështjen në themel edhe në këndvështrim të synimit kryesor dhe të shprehur në nenin 274 të KPP-së, si baza ligjore për caktimin e kësaj mase ndaj kërkueses, ashtu edhe nëse kufizimi i vetëm disa prej tagrave të pronësisë, siç është disponimi i lirë i sendit, do të ishte një masë e përshtatshme për të evituar tjetërsimin e tij, pra nëse do të siguronte balancën e drejtë mes interesit të përgjithshëm publik dhe të drejtave të personit të dyshuar, i cili deri në deklarimin e fajësisë me vendim përfundimtar të formës së prerë gëzon, gjithashtu, edhe të drejtën për t'ë prezumuar i pafajshëm, sipas nenit 30 të Kushtetutës.

24. Sipas nenit 31/a të ligjit nr. 8577/2000 dhe nenit 25, pika 5, të Rregullores së Gjykatës, vendimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve për kalimin ose moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare merret me shumicën e votave të gjyqtarëve që marrin pjesë në mbledhje. Po sipas kësaj dispozite të fundit, moskalimi vendoset në rast se nuk plotësohet qoftë edhe njëri nga kriteret e pranueshmërisë.

25. Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se qëndrimi i mësipërm i gjyqtarëve për mosplotësimin e kriterit të legjitimitetit *ratione materiae* i është bashkuar në drejtim të plotësimin kumulativ të të gjitha kriterëve të legjitimitetit, qëndrimin të gjyqtarëve për mosplotësimin e kriterit të shterimit të mjeteve juridike, sipas të cilit vendimet objekt kërkese janë jopërfundimtare, ndaj nuk mund t'i nënshtrohen gjykimit kushtetues. Sipas këtij qëndrimi<sup>4</sup>, në përputhje edhe me qasjen e mëparshme të Gjykatës, vendimet gjyqësore për vendosjen e masës së sekuestros preventive ndaj një pasurie, në kuadër të një procedimi penal, nuk përfshihen në juridiksionin kushtetues. *Së pari*, këto vendime të ndërmjetme, me karakter të përkohshëm, nuk kanë masën e duhur të autonomisë nga procesi i themelit (pjesë e të cilit është edhe konfiskimi i pasurisë), vendim i cili ka aftësinë të ndryshojë dhe të riparojë në masën e duhur efektet që ka sjellë sekuestrimi. Masa e sekuestros preventive, pavarësisht se vendoset për mbarëvajtjen e procesit penal, nuk përcakton rezultatin e tij, ndaj të drejtat që vihen në diskutim në kuadër të kësaj mase nuk mund të gëzojnë mbrojtje kushtetuese. Legjislacioni procedural penal i garanton individit mjete juridike për mbrojtjen nga masa e sekuestrimit (preventiv), qoftë për të kundërshtuar vendosjen e masës në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm, ashtu dhe për të kërkuar përpara këtyre gjykatave heqjen e masës në çdo rast kur ndryshojnë kushtet e zbatimit të saj. Në këtë kuptim, individit i garantohet mbrojtja kushtetuese përpara gjykatave të zakonshme qoftë në drejtim të së drejtës substanciale të pronës private, ashtu edhe për sa i përket vetë kohëzgjatjes së këtij procesi, i cili është i ndërvarur nga procesi i themelit për përcaktimin e fajësisë ose pafajësisë, për sa kohë që

---

<sup>4</sup> Gjyqtarët Ilir Toska dhe Marjana Semini votuan për moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

ato gjykata kanë kompetencën që të shqyrtojnë në themel edhe pretendimet për cenimin e të drejtave themelore. *Së dyti*, fakti që masa e sekuestros preventive mund të rivlerësohet (të hiqet) nga gjykatat e zakonshme, mund të passjellë mbivendosje të juridiksionit kushtetues me atë të zakonshëm gjyqësor, ndaj përfshirja në juridiksionin kushtetues të këtyre masave mund të kthehet në një mjet joefektiv, përveçse, në hipotezën e rezultateve të ndryshme të proceseve në këto dy juridiksione, mund të krijohen premisa për pasiguri juridike.

26. Për sa më sipër, në situatën që shumica e gjyqtarëve kanë votuar se në rastin konkret nuk plotësohen në mënyrë kumulative kriteret e legjitimitit, pavarësisht shkakut mbi të cilin e kanë mbështetur këtë qëndrim, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se është arritur shumica e kërkuar për moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, në kuptim të përmbajtjes së nenit 31/a të ligjit nr. 8577/2000 dhe nenit 25, pika 5, të Rregullores së Gjykatës.

27. Në përfundim, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Mbledhja e Gjyqtarëve, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronjat “d” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe neneve 23 e 25 të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese,

### **V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.